



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 634/prot.
7

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 68, datë 05.122025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 54, DATË 25.09.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr.54, datë 27.09.2024, të Komisionerit, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Kuçovë",

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 44, datë 21.03.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Kuçovë", ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në institucionin Bashkia Kuçovë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.54, datë 27.09.2024, të Komisionerit, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Kuçovë", ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 53, datë 24.06.2025, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 54, datë 25.09.2024, të Komisionerit”, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 54, datë 25.09.2024, në institucionin Bashkia Kuçovë, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr. 634/1, datë 24.06.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me shkresën nr. 634/2, datë 24.06.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 54, datë 25.09.2024 të Komisionerit”. Në zbatim të këtyre akteve, grupi i punës është paraqitur pranë institucionit të mbikëqyrur dhe, në përfundim të procesit, ka hartuar aktin e konstatimit, në të cilin është pasqyruar niveli i rregullimit të ligjshmërisë dhe është administruar dokumentacioni që provon zbatimin e pjesshëm të vendimit objekt verifikimi.

Në vijim, nisur nga shqetësimi i drejtuesit të njësive përgjegjëse të institucionit lidhur me mënyrën se si duhej të veprimej në rastin e deklarimit të statusit të punësimit në përfundim të periudhës së provës për 6 nëpunës, në zbatim të pikës 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri, me shkresën nr. 634/3 prot., datë 08.07.2025, dërguar Bashkisë Kuçovë, e ka orientuar këtë të fundit në lidhje me hapat që duhet të ndërmarrë dhe ka kërkuar marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e vendimit, duke i lënë një afat të ri deri më datë 20.07.2025. Në përgjigje të kësaj shkrese, Bashkia Kuçovë, me shkresën nr.634/4 prot., datë 28.07.2025, e më tej me *e-mailin* e datës 02.10.2025, ka përcjellë disa akte që dokumentojnë zbatimin e pjesshëm të detyrave të vendimit paralajmërues.

Më tej, me qëllim lehtësimin e procesit dhe sigurimin e një zbatimi sa më efektiv të detyrave të përcaktuara, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me njësine përgjegjëse të subjektit, si nëpërmjet korrespondencës elektronike, ashtu edhe përmes komunikimeve telefonike, duke ofruar asistencën e nevojshme për sqarimin e paqartësive të hasura gjatë procesit të zbatimit të plotë të vendimit të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 54, datë 25.09.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, përfshirë komunikimin shkresor dhe atë elektronik (*me e-mail*), situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Për sa i përket **pikës 2** të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse të ndjekë procesin e konfirmimit të nëpunësve për të cilët ka përfunduar afati 1-vjeçar i periudhës së provës, për 6 punonjësit e përmendur në raport.

Në kushtet e paqartësisë së hasur nga njësia përgjegjëse për zbatimin e kësaj detyre, për shkak të rrethanave specifike të evidentuara në procesverbalin e mbajtur gjatë verifikimit në subjekt, Komisioneri, me shkresën nr. 634/3 prot., datë 08.07.2025, e ka orientuar atë në lidhje me hapat konkretë që duhet të ndërmarrë për zgjidhjen e situatës dhe rikthimin e ligjshmërisë. Rezulton se, njësia përgjegjëse ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në përputhje me orientimet e Komisionerit dhe me shkresën e regjistruar pranë këtij të fundit

me nr. 634/4 prot., datë 28.07.2025, ka dërguar pranë Komisionerit aktet e deklaramit të statusit të nëpunësit civil, për nëpunësit në fjalë. Konkretisht:

- Me aktin 2378 prot., datë 16.07.2025, Erion Fetahu u deklarua nëpunës civil në pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”.
- Me aktin nr. 2376 prot., datë 16.07.2025, Admir Zyla u deklarua nëpunës civil në pozicionin “*Specialist i politikave të menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe për shërbimet me sipërmarrjen*”, në Drejtorinë e Transporteve, Shërbimeve Publike, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mjedisit.
- Me aktin nr. 2375 prot., datë 16.07.2025, Karafil Marra u deklarua nëpunës civil në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë dhe i Blegtorisë*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Kontrollit Ushqimor dhe Veterinar.
- Me aktin nr. 2377 prot., datë 16.07.2025, Ledja Lame u deklarua nëpunëse civile në pozicionin “*Specialist i regjistrimit të pronave*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Koordinimit–Zhvillimit Strategjik.
- Me aktin nr. 2379 prot., datë 16.07.2025, Erion Daci u deklarua nëpunës civil në pozicionin “*Specialist për marrëdhënien me publikun*”, në Drejtorinë Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
- Me aktin nr. 2380 prot., datë 16.07.2025, Fatbardha Beqiraj u deklarua nëpunëse civile në pozicionin “*Specialist për marrëdhënien me publikun*”, në Drejtorinë Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Në pikën 3 njësia përgjegjëse është ngarkuar të përcaktojë nëpunësin civil ose grupin e punës përgjegjës për mbledhjen e informacionit mbi pozicionet e punës në strukturë që bëjnë pjesë në shërbimin civil, si dhe për analizimin e këtij informacioni, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave për secilin pozicion. Është kërkuar që materiali i përgatitur t’u përcillet zyrtarisht nëpunësve përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës.

Nga dokumentacioni i administruar, i përcjellë me shkresën nr. 331/1 prot., datë 20.03.2025, rezulton se njësia përgjegjëse, me shkresën nr. 2920 prot., datë 29.09.2024, ka njoftuar të gjitha drejtoritë e Bashkisë Kuçovë për fillimin e procedurës së ristrukturimit të institucionit. Gjithashtu, nga verifikimi konstatohet se njësia përgjegjëse, me shkresën “*Njoftimin për fillimin e procesit të hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil*”, nr. 3654 prot., datë 29.10.2024, e ka adresuar këtë njoftim drejt titullarëve të çdo drejtorie dhe administratorëve të Njësive Administrative të institucionit.

Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit paralajmërues, nga ana e Komisionerit kërkohet që, pasi të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, njësia

përgjegjëse e institucionit të përgatisë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës.

Njësia përgjegjëse shprehet se, lidhur me këtë detyrë, nuk janë ndërmarrë masa të tjera përveç dërgimit të akteve të njoftimit për fillimin e procedurës së ristrukturimit të institucionit dhe njoftimit për fillimin e procesit të hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil, të evidentuara më sipër në pikën 3.

Në **pikën 5** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të krijojë Komitetin e Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve në shërbimin civil.

Konstatohet se, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit me anë të Urdhrit nr. 346, datë 06.11.2024, *“Për ngritjen e Komitetit të Vlerësimit, në Kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil të Bashkisë Kuçovë”*, ka ngritur Komitetin e vlerësimit, në përputhje me ligjin dhe orientimet e Komisionerit në vendimin paralajmërues dhe raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Në **pikën 6** të këtij vendimi, është kërkuar që Komiteti i vlerësimit, pas administrimit të dokumentacionit të domosdoshëm, të identifikojë me saktësi pozicionet e punës që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit, ku në përfundim të tij duhet të hartohet një listë përmbledhëse ku të pasqyrohen pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në kategorinë dhe klasën përkatëse, e cila në vijim i duhet përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit si dhe njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në zbatim të kësaj pike, konstatohet se, me aktin nr.346, datë 06.11.2024, është ngritur Komiteti i Vlerësimit, në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil në institucionin e Bashkisë Kuçovë, duke zbatuar pjesërisht detyrat e lëna në këtë pikë të vendimit.

Në **pikën 7**, i është kërkuar institucionit të Bashkisë Kuçovë që Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve në shërbimin civil të bashkëpunojë dhe të këshillohet me Departamentin e Administratës Publike, siç përcaktohet në pikën 37, kreu V, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave.

Nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton që institucioni i Bashkisë Kuçovë t’i jetë drejtuar Departamentit të Administratës Publike për t’i kërkuar asistencë për hartimin e listës përmbledhëse të klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, në kushtet kur nuk është ezauruar puna përgatitore për këtë proces.

Në **pikën 8** të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri i ka kërkuar Kryetarit të Bashkisë, që të konstatohet absolute e akteve të emërimit në kundërshtim me ligjin për punonjësit F. Doksani, në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Investimeve, Pronave Publike dhe Emergjencave Civile”*; R. Harizi, në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Bujqësisë dhe Blegtorisë”*; S. Shehu, i komanduar për kohësisht në

pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Transporteve, Shërbimeve Publike...”; dhe E. Lacka, në pozicionin e punës “Specialiste për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje”. Njësia përgjegjëse të shpallë menjëherë për t’u plotësuar në përputhje me ligjin pozicionet e punës si më sipër.

Rezulton se, me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë “Përmiratimin e Planit Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë Kuçovë për vitin 2025”, është miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil ku përfshihen pozicionet e punës të plotësuara në kundërshtim me ligjin.

Më tej, me aktin nr. 3407 prot., datë 30.09.2025, institucioni i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për publikimin e pozicioneve të lira si më poshtë:

- Pozicioni “Drejtor” në Drejtorinë e Transporteve, Shërbimeve Publike, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mjedisit, kategoria e pagës II-2;
- pozicioni “Specialist për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje” në Drejtorinë e Shërbimit Social, kategoria e pagës IV-2.

Në vijim, me Urdhrin nr. 44, datë 28.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, është ndërprerë marrëdhënia financiare për znj. Eralda Lacka, “Specialist për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje” në Drejtorinë e Shërbimit Social.

Gjithashtu, rezulton se z. Rakip Harizi, ka kaluar nga pozicioni i punës “Përgjegjës i Bujqësisë dhe Blegtorisë” në pozicionin “Specialist i Bujqësisë dhe Blegtorisë”, dhe më tej, me Urdhrin nr. 245, datë 20.08.2025, është ndërprerë marrëdhënia financiare e këtij punonjësi në këtë pozicion pune.

Në përfundim, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, vlerësoj se Bashkia Kuçovë ka zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmërues nr.54, datë 27.09.2024, të Komisionerit.

Sa i takon dy aspekteve më problematike që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, vlen të theksohet se nga institucioni kanë filluar të merren masa.

Duke qenë se këto nuk janë procese të lehta dhe kërkojnë një periudhë kohore të domosdoshme përtej afatit paralajmërues të përcaktuar nga Komisioneri, si dhe mbështetur në faktin se njësia përgjegjëse ka shfaqur paqartësi në njohjen dhe më tej zbatimin e saktë të ligjit lidhur me procesin e ristrukturimit, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin nuk janë përfshirë të gjitha në planin e rekrutimit, me synim plotësimin e tyre në përputhje të plotë me procedurat ligjore, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për strukturat e bashkive. Në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni mund të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme ose tematike gjatë vitit 2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.54, datë 27.09.2024, të Komisionerit, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Kuçovë".
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kuçovë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

